

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“GJINKALLA ” SH.P.K.

Themeluesi qe nenshkruan me poshte si vijon:

Kastriot TAFA, i biri i Jonusit, i datelindjes 29.05.1980, lindur ne Ternove, Diber dhe banues ne Tirane, mbajtes i kartes se Identitetit me nr.037716138 madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Qe ne vijim do te quhet Ortaku i Shoqerise “GJINKALLA” SHPK.

Sot me date 31.05.2023, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosi te themeloje Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i shoqerise

Shoqeria “GJINKALLA” SHPK, ka si objekt veprimtarie kryerjen e cdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe /ose pjesemarrjen ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryej nje shoqeri ne baze te legjislacionit shqiptar dhe ne vecanti:

1. Prodhim ambalazhim tregtim uji natyral,
2. Aktivitete te turizmit rural.

Neni 2

Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

Ortaku vendosi qe shoqerine t’a emertojne “GJINKALLA” SHPK.

1. Selia juridike e Shoqerise ndodhet , ne adresen: Lagjia Minatori, Rrugë e Pazarit, Objekt Privat 3 katesh, Kati 2, me nr. Pasurie 2418/3 zona kadastrale 8612 , Bulqize, Shqiperi.
2. Shoqeria mund te krijojë qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.



Neni 3

Forma Juridike

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ORTAKEVE mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.



Kreu III

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar eshte **100 (njqind) Leke**.

Ai eshte i ndare ne **1 (nje) kuote** me vlere nominale **100 (njqind) Leke**.

Ortak i vetem i shoqerise eshte:

Kastriot Tafa, zotërues i **1(nje) kuote apo 100 %**, të kapitalit të shoqërisë.

Kreu IV

PERSONALITETI JURIDIK

Neni 7

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit , si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e NUIS te ushtrimit se veprimtarise.

Kreu V

ADMINISTRIMI

Neni 8

1. Shoqeria do te administrohet nga administratori **Kastriot Tafa**, i cili perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese) vjecare** dhe me te drejte rizgjedhje.
2. Administratori mund t'i delegoje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

Kreu VI

DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

1. Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut te saj.
2. Ky Akt shtypet dhe nenshkruset ne **3 (tre) kopje**, te gjitha me te njejten vlere ligjore.
3. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Kastriot Tafa

Kastriot Tafa
